



Funded by
the European Union

Ndikimi buxhetor i arsimit falas në universitetet publike



Dhjetor 2021

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Arsim falas apo lehtësim i pagesave të studentëve?	5
Ndikimi financiar i udhëzimit administrativ në të hyrat vetanake të universiteteve	6
Financimi i bazuar në performancë si mekanizëm afatgjatë	9
Përfundim	12
Aneks	13



Përmbledhje ekzekutive

Financimi i universiteteve publike në Kosovë është i rregulluar sipas Ligjit për arsimin e lartë. Burimet kryesore të financimit të universiteteve publike janë grantet qeveritare dhe pagesat direkte nga ana e studentëve. Të hyrat nga puna kërkimore dhe shitja e shërbimeve përbëjnë një nga burimet shtesë për disa universitete, megjithëse edhe për to shuma e inkasuar nga këto burime alternative është e vogël në krahasim me dy kategoritë e para. Grantet qeveritare përcaktohen nga Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa pagesat e studentëve për shkollim përcaktohen nga Ministria e Arsimit përmes një udhëzimi administrativ të veçantë. Ky raport analizon ndikimin financiar të udhëzimit administrativ të aprovuar në vitin 2021, përmes të cilit u liruan studentët e nivelit bachelor dhe master nga pagesat e shkollimit.

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se gjatë vitit 2020, të hyrat vetanake të universiteteve publike arritën vlerën prej rreth 4.5 milionë euro, kurse vlera e grantit qeveritar ishte rreth 48 milionë euro. Sipas llogaritjeve bazuar në të dhënat e të hyrave vetanake të realizuara nga universitetet në vitin 2020, me zbatimin e udhëzimit të ri administrativ, gjithsej shuma e vlerësuar e të hyrave vetanake të universiteteve që do duhej të rimbursohet është rreth 2.6 milionë euro. Kompensimi i kësaj shume do të ngrisë vlerën e granteve qeveritare për universitetet publike, rrjedhimisht do të ketë alokim më të lartë të buxhetit. Përderisa një politikë e tillë është në favor të studentëve dhe kompensimi nga ana e shtetit siguron stabilitet financiar të universiteteve publike, institucionet shtetërore duhet të shikojnë edhe nga aspekti i reformimit të menaxhimit të parasë publike. Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të punojë në ndërtimin e mekanizmit të buxhetimit të bazuar në performancë, i cili kërkon përpilim të saktë të indikatorëve të performancës dhe ngritje të kapaciteteve të mekanizmave vlerësues.

Hyrje

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, institucionet e Kosovës, gjegjësisht Qeveria dhe Kuvendi, kanë themeluar gjashtë universitete publike. Përderisa themelimi dhe financimi i institucioneve të arsimit të lartë në përgjithësi rregullohet përmes Ligjit Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, funksionimi i universiteteve publike varet edhe nga politikat dhe vendimet e institucioneve tjera kompetente si Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Kjo e fundit ka akredituar gjithsej nëntë institucione publike të arsimit të lartë, megjithatë vetëm shtatë prej tyre mbajnë statusin e universitetit.

Financimi i këtyre institucioneve është i rregulluar sipas Ligjit për arsimin e lartë. Neni 20 flet për parimet kryesore të financimit të bartësve të arsimit të lartë, sipas të cilit burimet e financimit do të jenë:

- Fondet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për mësimdhënie dhe kërkime shkencore (grantet qeveritare);
- Pagesat e studentëve për shkollim dhe shërbime administrative;
- Shërbimet komerciale dhe të tjera;
- Donacionet, dhuratat, e të tjera; dhe
- Kontratat me organizmat shtetërorë ose ndërkombëtarë për mësimdhënie, kërkime shkencore apo këshillim.¹

Nga raportet vjetore të universiteteve publike, del se granti qeveritar dhe pagesat e studentëve përbëjnë të hyrat kryesore të këtyre universiteteve. Përderisa Ligji mbi buxhetin e Republikës së Kosovës përcakton shumën e grantit qeveritar, shumën e pagesave të studentëve për shkollim përcaktohet nga MASHTI me një udhëzim të veçantë administrativ, i cili sipas Ligjit rishqyrtohet çdo vit.² Ky udhëzim administrativ, që përcakton tarifën e shkollimit dhe shërbimeve të tjera administrative për studentët, është ndryshuar disa herë, varësisht nga politikat e partisë në pushtet. Dy ndryshimet më të mëdha kanë ndodhur në vitin 2014, kur pagesa për shkollim në universitetet publike u përgjysmua dhe disa kategori sociale u liruan krejtësisht, dhe ndryshimi i radhës në shtator 2021, me ç'rast u largua komplet pagesa e shkollimit.

Ky raport analizon ndikimin e mundshëm të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2021 për aplikimin e pagesave të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë në qëndrueshmërinë financiare të universiteteve publike dhe ofron një perspektivë mbi financimin e bazuar në performancë si masë për ngritjen e cilësisë dhe konkurrencës mes universiteteve publike. Analiza fokusohet në ndikimin e UA nr. 09/2021 në të hyrat vetanake të shtatë universiteteve publike e që janë: Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka", Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj, si dhe ofron vlerësim të vlerës financiare të parashikuar që duhet të mbulohet nga grantet qeveritare.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011), Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë, Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

2 Ibid. Neni 30

Arsim falas apo lehtësim i pagesave të studentëve?

Në shtator të vitit 2021, MASHTI aprovoi Udhëzimin Administrativ nr. 09/2021 për aplikimin e pagesave të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë.³ Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e pagesave për shkollim dhe shpenzimeve të tjera administrative të studentëve në universitetet publike në Kosovë, si dhe kushtet për lirim nga këto pagesa. Tarifat e përcaktuara të shkollimit dhe shpenzimeve administrative janë të shfaqura në tabelën në Aneks 1.

Përmes këtij udhëzimi, të gjithë studentët e nivelit bachelor dhe master, pa përjashtim, të cilët e regjistrojnë semestrin për herë të parë, janë të liruar nga pagesa e tarifës së shkollimit (25€ për nivelin bachelor dhe 150€ për nivelin master). Kjo nënkupton se nëse i njëjti semestër përsëritet dy e më shumë herë, tarifat e pagesave zbatohen si në tabelën në Aneks 1. Për më shumë, studentët lirohen edhe nga pagesat administrative për provim pranues (2.5€) dhe për secilin provim diferencial për regjistrimin e studimeve të nivelit master (5€). Në anën tjetër, studentët e doktoratës lirohen vetëm nga pagesa e semestrit të përsëritur, në rastet kur kjo përsëritje është shkaktuar nga rrethana të tjera, jashtë kontrollit të tyre.

Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, është shfuqizuar udhëzimi administrativ që ka qenë në fuqi deri më tani, ai i vitit 2014. Udhëzimi administrativ i aprovuar në vitin 2014 pati bërë uljen e të gjitha tarifave të shkollimit dhe shpenzimeve administrative, si dhe pati liru nga pagesat e tarifave të shkollimit vetëm disa kategori të caktuara të studentëve.⁴ Këto kategori përfshinin: të gjithë shtetasit e Kosovës që fillojnë në vitin e parë të studimeve, studentët prej familjeve në të cilat një fëmijë është i regjistruar në universitet publik (fëmijët tjerë janë të liruar nga pagesa), studentët që nuk kanë mundësi ekonomike për financim të studimeve, dhe të tjera të cilat përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi. Tarifat e shkollimit janë të njejta me ato të listuara në Tabelën në Aneks 1, ndërsa ato të shpenzimeve administrative kanë disa ndryshime të vogla, siç do të shpjegohen më poshtë.

Në krahasim me udhëzimin administrativ të vitit 2014, tani të gjithë studentët e nivelit bachelor dhe master trajtohen njejtë përgjatë gjithë periudhës së studimeve, dhe përfitojnë nga lirimi i tarifave përderisa semestri regjistrohet për herë të parë dhe vetëm një herë. Ndërsa, në kategorinë e shpenzimeve administrative, në UA nr.09/2021 është shtuar edhe kategoria e pagesave për paraqitje të provimit për herë të dytë e tutje, për të gjitha nivelet. Tarifat e kësaj kategorie janë: 1 euro, 2.5 euro dhe 5 euro për nivelet bachelor, master dhe doktoratë, respektivisht. Për më shumë, është hequr kategoria e tarifës për indeks dublikat në vlerë 25 euro, dhe është shtuar ajo për ID dublikat në vlerë prej 10 euro.

Në përgjithësi, udhëzimi i ri administrativ favorizon studentët, por ndikon në të hyrat e planifikuara vetanake të universiteteve publike. Edhe pse ky udhëzim fillon së zbatuari nga viti akademik 2021/2022, aty nuk parashihet ndonjë formë e kompenzimit nga ana e qeverisë për humbjet financiare nga pagesat e studentëve. Por cili është ndikimi financiar i këtij udhëzimi administrativ në buxhetin e universiteteve publike?

3 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2021), Udhëzim Administrativ nr. 09/2021 për Aplikimin e pagesave të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë, Burimi: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/10/ua-pagesa-converted.pdf>

4 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2014), Udhëzim Administrativ nr. 17/2014 për aplikimin e pagesave të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë, Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10143>

Ndikimi financiar i udhëzimit administrativ në të hyrat vetanake të universiteteve

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin bachelor për vitin akademik 2020/2021 në shtatë universitete publike është 46,027, ndërsa në nivelin master 7,925. Nga këto, universiteti me numrin më të madh të studentëve është Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me 27,124 studentë në nivelin bachelor dhe 5,836 studentë në nivelin master, ndërsa numrin më të vogël të studentëve e ka Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me 1,249 studentë në nivelin bachelor dhe 201 në nivelin master (shih Tabelën 1).⁵ Gati të gjitha universitetet e listuara ofrojnë studime edhe të nivelit bachelor dhe master, përveç atij të Gjakovës i cili nuk ofron studime master, dhe atij të Prishtinës që ofron edhe studime të doktoratës.

Tabela 1. Numri i studentëve të regjistruar dhe i përgjithshëm në nivelin bachelor dhe master në universitetet publike në Kosovë për vitin akademik 2020/2021

Universiteti	Numri i studentëve të regjistruar – Bachelor	Numri i përgjithshëm i studentëve – Bachelor	Numri i studentëve të regjistruar – Master	Numri i përgjithshëm i studentëve – Master
Universiteti i Prishtinës	5,274	27,124	2,016	5,836
Universiteti i Prizrenit	1,365	3,982	174	348
Universiteti i Pejës	812	7,772	247	1,193
Universiteti i Gjakovës	323	1,517	-	-
Universiteti i Gjilanit	725	2,350	76	191
Universiteti i Mitrovicës	832	2,033	62	156
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	516	1,249	130	201
Total	9,847	46,027	2,705	7,925

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21 (MASHTI dhe ASK)

Siç është e paraparë edhe me Ligjin për arsimin e lartë, universitetet publike në Kosovë financohen kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë mesatarisht 91 përqind të gjithsej buxhetit të tyre. Gjithashtu, ato financohen edhe nga të hyrat vetanake nga pagesat e ndryshme të studentëve, që përbëjnë rreth 9 përqind të gjithsej buxhetit të tyre. Në krahasim me universitetet e tjera, Universiteti i Prishtinës ka të hyrat vetanake më të larta si përqindje e gjithsej buxhetit, rreth 11.4 përqind.⁶

Gjatë vitit 2020, gjithsej buxheti i universiteteve publike arriti vlerën prej 52 milionë euro, ku rreth 48 milionë euro ishin nga grantet qeveritare, dhe rreth 4.5 milionë euro nga të hyrat vetanake (Tabela 2).

5 MASHTI dhe ASK (2021), Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021, Burimi: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2020-21.pdf>

6 Ministria e Financave (2020), Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Burimi: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

Tabela 2. Buxheti i përgjithshëm për universitetet publike për vitin 2020

Burimet e financimit	Grantet qeveritare	Të hyrat vetanake	Gjithsej buxheti
Universiteti i Prishtinës	€ 30,929,976	€ 3,997,750	€ 34,927,726
Universiteti i Prizrenit	€ 2,518,728	€ 105,000	€ 2,623,728
Universiteti i Pejës	€ 3,760,132	€ 105,000	€ 3,865,132
Universiteti i Gjakovës	€ 2,301,167	€ 58,879	€ 2,360,046
Universiteti i Gjilanit	€ 2,300,122	€ 113,860	€ 2,413,982
Universiteti i Mitrovicës	€ 4,096,584	€ 114,661	€ 4,211,245
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	€ 1,745,908	€ 31,174	€ 1,777,082
Gjithsej universitetet	€ 47,652,617	€ 4,526,324	€ 52,178,941

Burimi: Ministria e Financave, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Miratimi i udhëzimit të ri administrativ, përmes së cilit studentët lirohen nga pagesat për semestër dhe disa nga shpenzimet administrative, do të ketë ndikim direkt në zvogëlimin e të hyrave vetanake të universiteteve publike. Rrjedhimisht, këto të hyra do të mbulohen nga burime të tjera të financimit, në këtë rast nga grantet qeveritare.⁷

Në këtë analizë, në mënyrë që të bëhet llogaritja sa më e saktë, të dhënat e të hyrave vetanake përfshijnë vetëm kategoritë për të cilat studentët do të lirohen nga pagesa përmes këtij udhëzimi administrativ (09/2021). Këto kategori përfshijnë: pagesat për semestër për studentët e rregullt bachelor dhe master që regjistrojnë semestrin për herë të parë, pagesat për provim pranues (bachelor dhe master), dhe pagesat për provimet diferenciale të nivelit master. Të dhënat e përdorura janë për vitin 2020.

Sipas të dhënave të dërguara nga shtatë universitetet publike për vitin 2020 (Tabela 3), gjithsej të hyrat e realizuara për pagesa të semestrit për studentët e rregullt në nivel bachelor ishin rreth 1.4 milionë euro. Nga këto, mesatarisht një milion euro ishin të hyrat e Universitetit të Prishtinës, ndërsa rreth 370 mijë euro të hyrat e universiteteve tjera. Ndërsa për nivelin master, gjithsej të hyrat ishin rreth 1.1 milion euro, prej të cilave 973 mijë për Universitetin e Prishtinës, dhe rreth 184 mijë për universitetet tjera. Të hyrat e realizuara nga pagesat për provim pranues dhe provimet diferenciale të nivelit master ishin rreth 56 mijë euro.

⁷ MASHTI. Nga viti akademik 2021/2022 arsimit publik do të jetë pa pagesë. 17 shtator 2021. Burimi: <https://masht.rks-gov.net/article/nga-viti-akademik-20212022-arsimi-i-larte-publik-do-te-jete-pa-pagese>

Tabela 3. Të hyrat vetanake të realizuara të universiteteve publike për vitin 2020 (kategoritë për të cilat studentët do të lirohen nga pagesa me UA/2021)

Kategoria e të hyrave vetanake	Pagesat për semestër për studentët e rregullt – Bachelor	Pagesat për semestër – Master	Pagesat për provim pranues (Bachelor dhe Master)	Pagesat për provimet diferenciale të nivelit Master	Gjithsej të hyrat
Universiteti i Prishtinës	€ 1,082,911	€ 973,052	€ 38,361	€ 890	€ 2,095,213
Universiteti i Prizrenit	€ 125,800	€ 65,550	€ 5,690	-	€ 197,040
Universiteti i Pejës	€ 52,435	€ 45,425	€ 2,483	-	€ 100,343
Universiteti i Gjakovës	€ 46,675	-	€ 943	-	€ 47,618
Universiteti i Gjilanit	€ 72,625	€ 26,250	€ 3,150	-	€ 102,025
Universiteti i Mitrovicës	€ 51,700	€ 12,450	€ 3,915	-	€ 68,065
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	€ 24,325	€ 34,950	€ 1,228	-	€ 60,503
Gjithsej universitetet	€ 1,456,471	€ 1,157,677	€ 55,768	€ 890	€ 2,670,806

Burimi: Të dhënat e dërguara nga universitetet publike (Universiteti i Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Ferizajit).

Në bazë të këtyre të dhënave, me zbatimin e udhëzimit të ri administrativ, gjithsej shuma e vlerësuar e të hyrave vetanake të universiteteve që do duhej të rimburohej është rreth 2.6 milionë euro, e që është për gati një milion euro më shumë se sa vlerësimi i bërë nga MASHTI.⁸ Kompensimi i kësaj shume do të ngrisë vlerën e granteve qeveritare për universitetet publike. Nëse analizohen gjithsej të hyrat vetanake të buxhetuara të universiteteve, me të hyrat për të cilat studentët janë liruar gjatë vitit 2020, diferenca është afërsisht 1.9 milionë euro. Në këtë vlerë mund të jenë një pjesë e të hyrave që nuk janë realizuar, dhe pjesa tjetër janë kategoritë e tjera të të hyrave vetanake për të cilat studentët nuk lirohen nga pagesat sipas UA/2021. Në rastin e universiteteve të Prizrenit dhe atij të Ferizajit, të hyrat e realizuara janë më të larta se ato të buxhetuara, për 92 mijë euro dhe 29 mijë euro, respektivisht.⁹

Tabela 4. Diferenca e të hyrave vetanake të buxhetuara dhe të hyrave vetanake të realizuara për katër kategoritë e liruar nga pagesa sipas UA/2021

Universitetet	Diferenca (të hyrat e buxhetuara-të hyrat e realizuara për 4 kategoritë)
Universiteti i Prishtinës	€ 1,902,537
Universiteti i Prizrenit	-€ 92,040
Universiteti i Pejës	€ 4,658
Universiteti i Gjakovës	€ 11,262
Universiteti i Gjilanit	€ 11,835
Universiteti i Mitrovicës	€ 46,596
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	-€ 29,329

Burimi: Instituti GAP (2021), llogaritje bazuar në të dhënat e Ligjit të Buxhetit dhe të dhënave të dërguara nga universitetet

8 MASHTI. Nga viti akademik 2021/2022 arsimit publik do të jetë pa pagesë. 17 shtator 2021. Burimi: <https://masht.rks-gov.net/article/nga-viti-akademik-20212022-arsimi-i-larte-publik-do-te-jete-pa-pagese>

9 Instituti GAP (2021), kalkulime bazuar në të dhënat e Ligjit të Buxhetit dhe të dhënat e dërguara nga universitetet

Sipas të dhënave të shfaqura në Tabelën 4, vlerësohet se të hyrat tjera vetanake (që nuk do të lirohen nga pagesa sipas UA nr.09/2021) për shumicën e universiteteve publike (përveç atij të Prishtinës) kanë vlerë relativisht të ulët në raport me gjithsej të hyrat vetanake. Vetëm në rastin e Universitetit të Mitrovicës, kjo shumë është më e lartë, në vlerë prej rreth 46 mijë euro, apo 40 përqind të gjithsej buxhetit. Kjo mund të jetë për disa arsye: mos-realizim i pagesave të buxhetuara, mbi-buxhetim i të hyrave, ose të hyrat e tjera janë në vlerë më të lartë.

Ndikimi i udhëzimit të ri administrativ për lirim të studentëve nga tarifat e shkollimit mund të vërehet edhe në buxhetin e planifikuar të të hyrave të universiteteve për vitin 2022 (shih Tabelën 5). Sipas të hyrave vetanake të buxhetuara nga universitetet për vitin 2022, vërehet se krahas vitit 2021, gjithsej shuma që duhet të rimburohet është në vlerë 3.6 milionë euro. Tek Universiteti i Prishtinës, gjithsej të hyrat vetanake janë planifikuar në vlerë 1.2 milionë euro, apo 2.8 milionë euro më pak se në vitin 2021. Ndërsa, tek universitetet e tjera publike, nuk është planifikuar ndonjë shumë për të hyrat vetanake për vitin 2022, dhe në krahasim me vitin 2021, janë afërsisht 800 mijë euro më pak të buxhetura në këtë kategori.¹⁰

Tabela 5. Të hyrat vetanake të buxhetuara të universiteteve për vitet 2020–2022

Të hyrat vetanake të buxhetuara në tri vitet e fundit

Universiteti	2020	2021	2022
Universiteti i Prishtinës	€ 3,997,750	€ 3,997,750	€ 1,200,000
Universiteti i Prizrenit	€ 105,000	€ 303,188	–
Universiteti i Pejës	€ 105,000	€ 175,971	–
Universiteti i Gjakovës	€ 58,879	€ 62,230	–
Universiteti i Gjilanit	€ 113,860	€ 124,187	–
Universiteti i Mitrovicës	€ 114,661	€ 114,661	–
Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj	€ 31,174	€ 38,552	–


Burimi: Ministria e Financave (2021), Ligji për Buxhetin 2020, 2021, 2022

Financimi i bazuar në performancë si mekanizëm afatgjatë


Mes viteve 2009 – 2015, në Kosovë janë themeluar gjashtë universitete publike.¹¹ Të gjitha këto kanë ndjekur modelin e financimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke siguruar shumicën e të hyrave nga Buxheti i Kosovës. Kërkesa për buxhet vjen nga ana e universiteteve, të cilat përpilojnë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për tri vitet e ardhshme. Por, përderisa numri i studentëve në shumicën e universiteteve ka pasur rënie, buxheti i tyre ka qëndruar mesatarisht në nivel të njejtë, me lëvizje jo shumë të mëdha, siç tregon Grafikoni 1 dhe Grafikoni 2.

¹⁰ Ministria e Financave (2021), Projektligji për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Burimi: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EF71901F-590B-40FE-BEB2-AA440A918852.pdf>

¹¹ Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" (2009), Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" (2011), Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" (2013), Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (2013), Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" (2013) dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (2015).

Figura 1. Numri i studentëve në universitetet publike

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2018/20 (MASHTI dhe ASK)

Figura 2. Buxheti i universiteteve publike

Burimi: Ministria e Financave, Ligji për Buxhetin 2018, 2019, 2020

Megjithatë, Ligji për arsimin e lartë parasheh një formulë ndryshe të caktimit të fondeve për bartësit e arsimit të lartë. Sipas Nenit 21 të këtij ligji, financimi i universiteteve publike duhet të jetë i bazuar në marrëveshjen e performancës: "Ministria, bazuar në performancën e fundit të bartësit dhe do të caktojë një vijë buxhetore për një cikël të financimit pesë vjeçar. Caktimi i fondeve për një bartës duhet të marrë formën e një marrëveshjeje të performancës, që do të zgjasë tri vjet dhe që do të publikohet nga Ministria pasi të jetë dakorduar me bartësin përkatës."¹²

Pra, sipas ligjit në fuqi, caktimi i fondeve për universitetet publike do duhej të bazohej në performancën e universitetit, arrijtjen e objektivave të parapara në planin strategjik të universitetit si dhe në vlerësimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) mbi cilësinë e mësimdhënies në atë universitet: "Ministria cakton fondet e bartësve të arsimit të lartë duke marrë parasysh objektivat e specifikuar në planin strategjik të bartësit dhe çfarëdo vërejtjesh apo rekomandimesh nga AKA-ja lidhur me cilësinë e mësimdhënies të këtyre bartësve ose të programeve të veçanta."¹³

Megjithatë, kjo formulë e financimit nuk është aplikuar deri më tani në Kosovë. Financimi i universiteteve i bazuar në performancë është pjesë e reformimit të përgjithshëm të menaxhimit të parasë publike që ka filluar së zbatuari nga shumë shtete të ndryshme kundrejt universiteteve publike, në veçanti në universitetet evropiane. Në shkëmbim të autonomisë menaxheriale nga ana e universiteteve, qeveritë filluan të ofrojnë mekanizma financimi që janë të kushtëzuar në vlerësimin e indikatorëve të performancës. Edhe pse ka studime që vlerësojnë se buxhetimi i bazuar në performancë nuk ka ndikuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies apo mësimnxënies dhe nuk ka rritur performancën e kërkimeve shkencore,¹⁴ kjo formulë e financimit rrit nivelin e llogaridhënies mbi shpenzimin e parasë publike dhe shton konkurrencën mes universiteteve. Zbatimi i kësaj formule të financimit nënkupton përpilimin e indikatorëve të saktë të performancës dhe instalimin e mekanizmave vlerësues nga ana e autoriteteve publike.

12 Neni 21, Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë, Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

13 Ibid.

14 Marcel Herbst, "Financing Public Universities: The case of performance funding", Springer: 2007

Përfundim

Burimet kryesore të financimit të universiteteve publike në Kosovë janë granti qeveritar dhe pagesat direkte nga ana e studentëve. Të hyrat nga puna kërkimore dhe shitja e shërbimeve përbëjnë një nga burimet shtesë për disa universitete¹⁵, megjithëse edhe për to shuma e inkasuar nga këto burime alternative është e vogël në krahasim me dy kategoritë e para. Por, udhëzimi i ri administrativ për aplikimin e pagesave të studentëve, i miratuar në shtator të këtij viti, do të redukton në mënyrë të dukshme të hyrat e universiteteve publike nga pagesat e studentëve. Kompensimi i tyre nga ana e buxhetit të shtetit nënkupton më shumë alokim të buxhetit për universitetet publike. Hendeku financiar i krijuar nga ky vendim i Qeverisë së Kosovës kap një kosto prej 2.6 milionë euro në vit, bazuar me vitin 2020.

Përderisa një politikë e tillë është në favor të studentëve dhe kompensimi nga ana e shtetit siguron stabilitet financiar të universiteteve publike, institucionet shtetërore duhet të shikojnë edhe nga aspekti i reformimit të menaxhimit të parasë publike.

Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të punojë në ndërtimin e mekanizmit të buxhetimit të bazuar në performancë, i cili kërkon përpilim të saktë të indikatorëve të performancës dhe ngritjen e kapaciteteve të mekanizmave vlerësues. Një formulë e tillë e financimit të bazuar në performancë parashihet edhe në Ligjin për Arsimin e Lartë, por që nuk është zbatuar deri më tani.

15 Universiteti i Prishtinës ka arkëtuar të hyra prej 40,751 euro nga shitja e shërbimeve gjatë vitit 2020 (shih KASH 2022–2024)

Aneks

Aneks 1. Tarifat e shkollimit dhe pagesat për shërbime administrative sipas Udhëzimit Administrativ 09/2021


Tarifat e shkollimit

Pagesat për semestër për studentët e rregullt, niveli Bachelor	25 €
Pagesa për semestër për studentët me korrespondencë niveli Bachelor	125 €
Pagesat për semestër për studentët e rregullt, niveli Master	150 €
Pagesa për semestër për studime të doktoratës	500 €
Pagesa për mbrojtjen e diplomës të studimeve Master	100 €
Pagesa për mbrojtjen e disertacionit të doktoratës	300 €

Pagesat për shërbime administrative

Pagesat për provim pranues	2.5 €
Pagesat për secilin provim diferencial për regjistrimin e studimeve të nivelit Master	5 €
Pagesat për paraqitje të provimit për herë të dytë e tutje, niveli Bachelor	1 €
Pagesat për paraqitje të provimit për herë të dytë e tutje, niveli Master	2.5 €
Pagesat për paraqitje të provimit për herë të dytë e tutje, niveli Doktoraturë	5 €
Pagesat për çertifikatë të notave	2.5 €
Pagesat për çertifikatë të diplomës	5 €
Pagesat për secilin provim të pranuar në rastin e transferimeve nga institucionet tjera	0.50 €
Pagesat për diplomë	5 €
Pagesat për diplomë dublikat	25 €
Pagesat për ID dublikat	10 €
Pagesat për ndërrim programi të studimeve	25 €

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit





Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

Ndikimi buxhetor i arsimit falas
në universitetet publike